



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 91, DATË 08.10.2020

PËR
RINOVIMIN E AUTORIZIMIT TË SHOQËRISË “TATA JUNIOR” SH.P.K., PËR
PËRSËRITJEN E SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE
MBËSHTETUR NË RRJET KABLLOR “TATA JUNIOR”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa b dhe nenit 55, pika 4, germa b të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017 si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1360 prot., datë 01.06.2020 të shoqërisë “Tata Junior” sh.p.k., për rinovimin e autorizimit për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tata Junior”, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tata Junior” sh.p.k., me NIPT: K89115601U dhe administrator: z. Ervin Tahiri, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tata Junior”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
2. Kushtet e autorizimit të shoqërisë “Tata Junior” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tata Junior”, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet prej datës 04.06.2020.

Kryetar:

Gentian

SALA

Zëvendëskryetar:

Sami

NEZAJ

Anëtarë:

Agron

GJEKMARKAJ

Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA